



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01 Nr. 05- 400-20754/2014

Kaçanik; 18. 07. 2014

Mbështetur në nenin 40.2 (b.) të Ligjit nr.03/L-040 – Për Vetëqeverisjen Lokale, të neneve 20.8, 22 dhe 25 të Ligjit Nr.03/L-048 – Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të Ligjit nr.03/L-221. – Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-048 – Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit, të nenit 13 dhe 14 të Ligjit nr.(2013/04-L-233).- Për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2014, të pikës 5 të Vendimit Për Buxhetin e Komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2014 dhe vlerësimet për vitet 2015-2016, të nenit 34.5 të Statutit të komunës si dhe nenit 15.1(b) e Rregullorës për Punë të Kuvendit, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e mbajtur më datë **18.07.2014**, merr këtë:

V E N D I M

PËR RISHIKIM TË BUXHETIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2014

1. Me këtë Vendim Buxheti i Komunës së Kaçanikut për vitin 2014, pas transfereve, ridestinineve dhe harmonizimeve brenda programeve dhe nën-programeve buxhetore, duke pas për bazë rritjen e pagave bazë për 25% duke filluar nga muaji prill i këtij viti, do të shtohet ashtu siç është përlllogaritur në Tabelën 4.1-vetëm ndryshimet e buxhetit.

2. Të Zyra e Kryetarit buxheti do të zvoglehët për 79,205 € te Shpenzimet Kapitale, ndërsa Pagat dhe Mëditjet do të kemi rritje për 10,411 € dhe te kategoria e Subvencioneve e Transfereve kemi rritje në shumë prej 15,000 € dhe zvoglim te Mallrat dhe Shërbimet (M&Sh) shumë prej 9,057 €.

3. Të Administrata dhe Personeli buxheti do të rritet për Paga dhe Mëditje 15,513 € ,ndërsa do të zvoglohet te Mallrat dhe Shërbimet për 12,498 €.

4.Të Zyra e Kuvendit Komunal buxheti do të rritet 972 € te kategoria ekonomike e Pagave dhe Mëditjeve dhe do të zvoglohet te Mallrat dhe Shërbimet për 1,350 € €.

5. Të Buxheti dhe Financa buxheti rritet te Pagat dhe Mëditjet për 10,782 € , ndërsa do të kemi zvoglim të M & Sh për 1,590 €.

6. Të Shërbimet Publike,Mbrojtja Civile dhe Emergjencia buxheti do të rritet për 46,015 tek Investimet Kapitale dhe për 16,341 € për Paga dhe Mëditje , ndërsa do të kemi zvoglim te M & Sh për 29,091 €.

7. Të Zyra Lokale e Komuniteteve ,buxheti do të rritet për 1,044 € te Pagat dhe Mëditjet ,ndërsa do të zvoglohet për 375 € te M & Sh.

8.Të Bujqësia , Pylltaria dhe Zhvillimi Rural, Buxheti për Paga dhe Mëditje do të rritet për 10,770 € , ndërsa te M & Sh do të kemi zvoglim për 2,775 € dhe te Investimet Kapitale zvoglim për 1,605 €

9. Të Planifikimi Urban dhe Mjedisi, Buxheti do të rritet në shumë prej 34,795 € dhe në dobi të Shpenzimeve Kapitale dhe për 11,732 në dobi të Pagave dhe Mëditjeve, ndërsa do të zvoglohen M & Sh për 1,050 €.

10. Të Shëndetësia Primare do të kemi rritje të Pagave dhe Mëditjeve për 76,817 € dhe Zvoglim të M & Sh për 22,773 €.

11. Të Shërbimet Rezidenciale dhe Sociale do të kemi rritje të buxhetit për Paga dhe Mëditje prej 4,911 € dhe zvoglim të M & Sh për 2,900 €.

12. Të Arsimi do të kemi rritje të Pagave dhe Mëditjeve për 416,240 €, rritje të Subvencioneve dhe Transfereve për 20,000 € dhe zvoglim të M & Sh për 36,075 €.

13. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi janë vetëm ndyshimet e bëra në Tabelën 4.1 dhe Tabelën 4.2 të Buxhetit të vitit 2014.

14. Për realizimin e këtij Vendimi, obligohet Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit, e cila drejtori të njejtin Vendim do ta zbaton në Ministrinë e Financave, respektivisht në Departamentin e Buxhetit dhe Departamentin e Thesarit.

15. Ky Vendim hyn në fuqi nga dita e aprovimit dhe do të vlejë për deri sa nuk merret ndonjë vendim tjetër.

Me këtë Vendim njoftohen:

1. Kryetari i Komunës,
2. Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim (nëpërmjet kësaj drejtorie njoftohen organet tjera relevante, dhe
3. Arkiva.



Kryesuesi i kuvendit,
Xhelal Gashi